REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

UDHËZUES

AKKSHI

PËR

PROJEKTET KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT (PKKZH)

Viti 2026

PËRMBAJTJA

KREU 1 ..... **3**
PROCEDURA E PARAQITJES DHE SHQYRTIMIT FORMAL PROJEKTEVE **3**
1.1 Rreth Programit të PKKZH-ve 3
1.2 Qëllimi i Programit të PKKZH-ve 3
1.3 Objektivat e Programit PKKZH 3
1.4 Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve 3
KREU 2 ..... **4**
PROCEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE **4**
2.1 Shpallja e thirrjes për aplikim për projekte 4
2.2 Organizimi i ditëve informative 4
2.3 Dokumentacioni i aplikimit 4
2.4 Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit 4
2.5 Shqyrtimi i dosjes së aplikimit 5
2.6 Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit 5
2.7 Njoftimi i fituesve 5
KREU 3 ..... **5**
VLERËSIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTEVE **5**
3.1 Qëllimi i vlerësimit dhe miratimit të projekteve 5
3.2 Procesi i vlerësimit 6
3.3 Procedura e miratimit për financim të projekteve 6
KREU 4 ..... **6**
ASPEKTE FINANCIARE TË PROJEKTEVE FITUESE DHE RAPORTIMI **6**
4.1 Financimi i projekteve fituese 6
4.2 Buxheti i detajuar (kostot e ndryshme) 7
4.3 Raportimi 8
4.4 Raporti përfundimtar (studim) 8
KREU 5 ..... **9**
MONITORIMI I PROJEKTEVE **9**
5.1 **Qëllimi i monitorimit** 9
5.2 **Fazat e monitorimit** 9
5.3 **Detyrimet e aplikantit** 9
5.4 **Raportet e monitorimit** 9
KREU 6 ..... **10**
ETIKA, PRONËSIA INTELEKTUALE, KONFLIKTI I INTERESTIT DHE KONFIDENCIALITETI **10**
KREU 7 ..... **10**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME **10**

KREU 1.
PROCEDURA E PARAQITJES DHE SHQYRTIMIT FORMAL PROJEKTEVE NË KUADRIN E PROGRAMIT

1.1 Rreth Programit të PKKZH-ve

Programet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit janë paraqitje sintetike e aktiviteteve sistematike kërkimore dhe zhvillimore, që ndërmerren për të arritur objektiva të caktuara në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik me rendësi për përparimin e vendit. Programet Kombëtare zbatohen nëpërmjet projekteve të kërkimit dhe mbështesin në aspektin kërkimor dhe zhvillimor Programin e Qeverisë për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të vendit.

1.2 Qëllimi i Programit të PKKZH-ve

Qëllimi i programit është të mbështesë realizimin e aktiviteteve të kërkimit shkencor dhe inovacionit në IAL dhe institucione kërkimore shkencore. Mbështetja ofrohet për projekte që përputhen me fushat prioritare kombëtare dhe zhvillimet rajonale dhe europiane të kërkimit shkencor si dhe për projekte të mbështetura në marrëveshje bashkëpunimi të IAL-ve dhe institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit ndërmjet tyre, ndërmjet IAL-ve dhe sektorit të biznesit si dhe projekte që nxisin inovacionin.

1.3 Objektivat e Programit PKKZH

Objektivat e programit të PKKZH-ve janë:

- Të mbështesë me grante projekte kërkimore të cilësisë së lartë që mundësojnë rritje të performancës së kërkuesëve dhe institucioneve shqiptare të kërkimit shkencor në përputhje me standardet e Zonës Evropiane të Kërkimit;
- Të mbështesë kërkimin shkencor dhe inovacionin në perputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit , shoqëror dhe kulturor të vendit, si dhe tendencave të zhvillimeve globale;
- Të vendosë kërkimin shkencor në qendër të zgjidhjes së problemeve dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit;
- Të nxisë inovacionin dhe zhvillimin teknologjik nëpërmjet bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë me komunitetin e biznesit;
- Të nxisë bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor ndërmjet institucioneve vendore të kërkimit shkencor dhe partnerëve ndërkombëtarë;

1.4 Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve

Vendimi Nr.607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", në pikën 4 të tij përcakton se kanë të drejtë të aplikojnë për financim të projekteve në kuadër të PKKZH, Institucionet e Arsimit të Lartë të përcaktuara si të tilla në pikën 4, të Nenit 4, të Ligjit Nr. 80/2015 të sipërcituar si

dhe institucionet publike e jopublike, që kanë për objekt të veprimtarisë për kërkimin shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane.

Në thirrjen për aplikime që miratohet nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, mund të përcaktohen edhe kritere të tjera më të detajuara për aplikantët.

KREU 2.
PROCEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE

2.1 Shpallja e thirrjes për aplikim për projekte

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit me vendim të Bordit të Administrimit, shpall në faqen zyrtare të internetit thirrjen për aplikim për projekte. Gjithashtu MA informon IAL mbi thirrjen e shpallur.

2.2 Organizimi i ditëve informative

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, gjate periudhës kur "Thirrja" qëndron e hapur, organizon ditë informative me kërkuesit shkencorë dhe përfaqësues të institucioneve dhe IAL-ve potencialisht të interesuara për thirrjen. Ditët informative organizohen me qëllim qartësimin e specifikimeve të thirrjes si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve që mund të kenë personat e interesuar për të marrë pjesë me projekt propozime në kuadrin e një thirrje të caktuar.

2.3 Dokumentacioni i aplikimit

Dokumentacioni për aplikim për projekte është hartuar nga AKKSHI dhe është i aksesueshëm nga të gjithë personat apo institucionet që janë të interesuar të aplikojnë në kuadrin e programit të PKKZH-ve, nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit. Paketa e dokumentave, siç janë forma e aplikimit, forma e propozimit financiar, etj., janë pjesë të këtij udhëzuesi. Çdo aplikim dorëzohet nëpërmjet protokollit në AKKSHI i shoqëruar me shkresë zyrtare të institucionit që aplikon (Agjencia ekzekutuese) për projektin. Projekt- propozimi duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Formës së Aplikimit të Projektit për Kërkim e Zhvillim (Aneks 1) dhe Formës së Propozimit Financiar (Aneks 2). Sqarimet për mënyrën e plotësimit të Dokumentit të Projektit për Kërkim dhe Zhvillim dhe të Formës së Propozimit Financiar gjenden në anekset përkatëse dhe detajohen në Ditët Informative që AKKSHI organizon për gjithë të interesuarit. Gjithashtu pjesë e dokumentacionit është Aneksi 3 "Deklarata e Angazhimit" e cila plotësohet nga i gjithë stafi i projekti (Grupi kërkimor). I gjithë dokumentacioni i kërkuar listohet në një "Listën e Dokumentacionit" e cila shoqëron paketën e projekt propozimit.

2.4 Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit

Dosja e aplikimit për një projekt kërkim zhvillimi, duhet të depozitohet në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit brenda afatit të përcaktuar në Thirrjen për aplikim të shpallur nga AKKSHI. Përcaktimi i afateve për depozitimin e aplikimit kryhet në përputhje me përcaktimet e nenit 53 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë". Llogaritja e

afateve të depozitimit të dosjes së aplikimit pranë AKKSHI, kryhet në përputhje me përcaktimet e neneve 56 dhe 57 të Ligjit nr.44/2015, "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë".

Aplikuesi mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, në përputhje me nenet 54 dhe 55 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë".

2.5 Shqyrtimi i dosjes së aplikimit

Në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, kontrolli formal bëhet në Drejtorinë e Programeve Kombëtare, në Sektorin e Programeve Kombëtare, që administron Projektet Kombëtare për Kërkim e Zhvillim. Ai synon të vlerësojë nëse projekt-propozimi është propozuar në fushën përkatëse, nëse përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar të plotësuar sipas kërkesave të këtij udhëzuesi dhe të thirrjes së miratuar nga Bordi i Administrimit të AKKSHI.

Projekt-propozimet që nuk kanë dokumentacion të plotë, kanë pasaktësi në plotësim, apo që nuk përmbushin kriteret dhe formatin standard të përcaktuar nga AKKSHI, skualifikohen që në fazën e shqyrtimit formal.

2.6 Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit

Projektet të cilat i janë përmbajtur kritereve administrative të vendosura nga AKKSHI së bashku me dokumentacionin përkatës, kalojnë në procesin e vlerësimit teknik nga komisionet e vlerësimit të projekteve.

2.7 Njoftimi i fituesve

Pasi vlerësohen nga komisionet e ekspertëve të vlerësimit dhe pasi zbardhet Vendimi i Bordit të Administrimit të AKKSHI për projektet të cilat do të financohen, fituesit njoftohen me shkresë zyrtare dhe gjithashtu vendimi i miratuar nga BA me listën përkatëse publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të AKKSHI.

KREU 3.
VLERËSIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTEVE

3.1 Qëllimi i vlerësimit dhe miratimit të projekteve

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të drejtimit të çdo aktiviteti shkencor. Atij i nënshtrohen të gjitha Projektet Kombëtare të financuara nga AKKSHI. Ai nevojitet për të evidentuar gjendjen reale të ecurisë së projekteve dhe për të përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e saj, për të nxjerrë përfundime të drejta lidhur me vlerën e vetë projekteve, rezultatit shkencor të projektit, problemet administrative, financiare si dhe mësime në lidhje me projektet e ardhshme. Ai synon të vlerësojë nëse projekt-propozimi është formuluar në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit[1] për të gjitha fushat prioritare.

[1] Strategjitë Kombëtare Sektoriale

3.2 Procesi i vlerësimit

a. Projekt-propozimi që kalon kontrollin formal e administrativ i jepet për ekspertizë Komisionit të Ekspertëve, që bën vlerësimin përmbajtësor e teknik të tij.
b. Komisioni i ekspertëve për kryerjen e vlerësimit përmbajtësor e teknik të projekt propozimeve, miratohet nga Bordi i Administrimit i AKKSHI-t pas një procesi të hapur aplikimesh nga kandidatët. Pjestarë të tij zgjidhen nga specialistë të fushave përkatëse që nuk janë pjestarë të personelit të projektit ose të organeve vendimmarrëse të institucioneve që e kanë propozuar atë.
c. Procesi i vlerësimit bëhet në përputhje me Skedën e Vlerësimit të Projekteve.
d. Komisioni i Ekspertëve përpara fillimit të procesit të vlerësimit, nënshkruan Deklaratën e Konfliktit të Interesit dhe të paanshmërisë dhe integritetit profesional.
e. Eksperti i vlerësimit shpërblehet për punën e kryer bazuar në VKM Nr. 567, datë 23.10.1995, "Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike". Në grupin e vlerësimit nuk përfshihen persona të cilët kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në aktet e hartimit, miratimit, zbatimit dhe drejtimit të projektit.

3.3 Procedura e miratimit për financim të projekteve

Procesi i miratimit për financim të projektit kalon përmes këtyre hapave:

a. Vlerësimet e Komisionit të Ekspertëve i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-së me procesverbalin përkatës të mbajtur nga çdo komision) dhe listën rankuese të firmosur nga ekspertët vlerësues. Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI përcjell listën e sipërpërmendur për përzgjedhjen dhe miratimin e projekteve fituese në Bordin e Administrimit.
b. Për projekt-propozimet që janë miratuar për financim nga Bordi i Administrimit, lidhet kontrata sipas modelit bashkëlidhur ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-së dhe institucionit shkencor që ka paraqitur kërkesën, të përfaqësuar nga drejtuesi i tij dhe drejtuesi i projektit.

KREU 4.
ASPEKTE FINANCIARE TË PROJEKTEVE FITUESE DHE RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E TYRE.

4.1 Financimi i projekteve fituese

a. Pas vlerësimit nga ekspertët e Komisioneve të vlerësimit, miratimit të projekteve fituese në Bordin e Administrimit dhe lidhjes së kontratës, përfituesi do të marrë fondin e përcaktuar, brenda një afati rreth 45 ditë pas shpalljes së vendimit për financimin e projektit.

a. Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të aktiviteteve të projektit mund të ndodhin vetëm pas një miratimi paraprak nga Bordi i AKKSHI-së.
b. Kërkesa për shtyrje të afatit të përfundimit të projektit dhe të dorëzimit të raportit përfundimtar miratohet nga AKKSHI pas shqyrtimit të argumentave të parashtruara nga kërkuesi.
c. Kërkesa duhet të dërgohet të paktën 15 (ditë) ditë përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga Bordi i AKKSHI-së. AKKSHI-ja njoftohet menjëherë në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet dhe numrin e llogarisë së përfituesit.

d. Ndryshimet në zërat buxhetore lejohen deri në një total prej 10 % të fondit të financuar nga AKKSHI-ja, **vetëm** brenda të njëjtit zë dhe mund të bëhen **vetëm** me miratimin paraprak të AKKSHI. Përfituesi në këtë rast duhet të njoftojë me shkrim AKKSHI-në duke argumentuar që ndryshimet e kërkuara nuk ndikojnë në cilësinë e realizimit të projektit dhe janë propozuar në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.
e. Të gjitha përgjegjësitë lidhur me shpenzimin e zërave buxhetorë sipas formatit financiar të miratuar (bashkëlidhur kontratës), si dhe zbatimit të kalendarit të aktiviteteve përkatëse në kuadër të projektit, janë të institucionit përfitues.

4.2 Buxheti i detajuar (kostot e ndryshme)

a. Pas miratimit për financim, drejtuesi i projektit risjell Planin e Financimit të detajuar të projektit në përputhje me kërkesat e AKKSHI.
b. Të gjitha shpenzimet e planifikuara duhet të bëhen brenda periudhës së zbatimit të projektit në përputhje me kalendarin e aktiviteteve dhe buxhetin e miratuar.
c. Pagesat e personelit të angazhuar në grupin e punës së projektit duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi dhe duhet t'i referohen kontratës të punës që çdo anëtar i projektit ka në IAL ose në institucionin që aplikon për projektin.
d. Pagesa e personelit të angazhuar në projekt përcaktohet në përputhje me kategorinë e vendit të punës, referuar Lidhjes nr.1 të VKM nr. 243, datë 20.4.2023, ""Për një ndryshim në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, ""Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë"". Përfituesit nga institucionet jopublike janë të detyruar të kenë të njëjtën referencë për pagesat e personelit të angazhuar në projekt.
e. Zëri paga për personelin duhet të zërë jo më shumë se 70% të buxhetit të projektit të kërkuar nga AKKSHI. Numri i ditëve të angazhimit në projekt është jo më shumë se 40 ditë /pune në 12 muaj/person. Numri maksimal i ditëve të angazhimit është 80 ditë/pune në 24 muaj/person. Periudha 6 mujore e planifikuar për publikimin e artikullit/artikujve shkencorë nuk përfshin ditë angazhimi me pagesë nga AKKSHI.
f. Kohëzgjatja e ditëve të punës për stafin teknik/administrativ është jo më shumë se 5-10 ditë pune, në varësi të kohëzgjatjes së projektit. Stafi teknik ndër të tjera mund të përfshijë pozicione pune si: kërkues shkencorë, pedagogë, bashkëpunëtorë shkencorë, laborant, IT, etj
g. Vërtetimi i pagës për çdo anëtar të grupit të punës duhet i gjeneruar nga e-Albania me datën më të afërt të aplikimit.
h. Stafi ndihmës është personeli që nuk kontribuon në kërkim shkencor por ka një kontribut në administrimin e aktivitetit të projektit.
i. Shpenzimet për **transport (publik brenda vendit) dieta dhe akomodim** në kuadër të aktiviteteve të projektit duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit"). Aplikanti do të duhet të argumentojë shpenzimet në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe objektivave të projektit. Gjatë implementimit të projektit, këto shpenzime do të justifikohen me dokumentat përkatëse.
j. Shpenzimet për **transport, dieta dhe akomodim** do të bëhen sipas VKM Nr.329, datë 20.04.2016 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" të ndryshuar.
k. Janë shpenzime të lejuara vetëm ato që lidhen me mobilitetin brenda vendit.

l. Në zërin "Publikime", përfshihen botime artikujsh shkencorë sipas specifikimeve të kuadrit ligjor përkatës[1] si dhe botime shkencore të tjera si: revista /buletine/ monografi/libra/ prezantime në konferenca shkencore të botuara në përmbledhjet e tyre/ etj. të cilat prodhohen në kuadër të projektit. Një artikull i publikuar në revistat e mësipërme është **produkt i detyruar** i projektit

m. Në rastin e publikimit të artikujve në revistat e botuara në RSH, ato duhet të përmbushin kriteret e kategorive A, B , C, referuar Urdhërit Nr. 36 date 24.1 2023 "Për miratimin e rregullores për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë".

n. Përfituesi i grantit ka detyrimin: a) të vendosë logon e AKKSHI-së në të gjithë informacionin lidhur me publikimet, aktivitetet që janë mundësuar me ndihmën financiare të AKKSHI-së, si dhe mbi të gjitha materialet, aktivitetet, faqet zyrtare të internetit dhe të tjera produkte; b) të përmendë financimin AKKSHI në të gjitha artikujt/botimet e financuara në kuadër të projektit.

o. Llojet e tjera të botimeve shkencore si: monografi/libra/ revista /buletine duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Monografia duhet të plotesoje kriteret e ëercaktuara në VKM Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", Kreu II, pika 5, shkronja "a".

p. Prezantimet në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), bëhen në konferenca shkencore të organizuara në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN, sipas VKM Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" .

q. Shpenzimet administrative përfshijnë materiale konsumi në funksion të realizimit të projektit që janë të domosdoshme për kryerjen e ekpserimenteve si kite/reagentë/etj., si dhe materiale promocionale në shërbim të pjesëmarrësve në konferencat shkencore të organizuara në kuadër të projektit.

r. Organizimi i konferencës shkencore për diseminimin e rezultateve të projektit **është i detyruar.**

s. Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financon Projektin:

1. Blerje e tokës.
2. Shit-blerje/qera makinash.
3. Shpenzime për karburant
4. Interes mbi huadhënie.
5. Marrëveshje huadhënie.

[1] Artikuj të botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator JCI), VKM Nr. 128, datë 6.3.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i asociuar' dhe 'Profesor", të ndryshuar"

6. Dhurime.
7. Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare.
8. Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit.
9. Nënkontraktimi i subjekteve private.
10. Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

4.3 Raportimi

a. Për projektet dorëzohet raport i ndërmjetëm mbi bazë kërkese të AKKSHI, i cili duhet të depozitohet në AKKSHI me shkresë përcjellëse të titullarit të institucionit përfitues. Raporti duhet të pasqyrojë realizimin e aktiviteteve dhe të shpenzimeve të planifikuara. Mënyra e paraqitjes së raportit vjetor duhet të jetë sipas formatit të AKKSHI.
b. Në përfundim të realizimit të projektit, të gjithë përfituesit dorëzojnë raportin përfundimtar.

4.4 Raporti përfundimtar (studim)

a. Në përfundim të çdo projekti për kërkim e zhvillim përpilohet raporti shkencor (studimi) përkatës. Ky raport, si dhe dokumente të tjera që përcaktohen në këtë udhëzim i paraqiten institucionit financues përgjegjës brenda afatit të parashikuar për përfundimin e projektit.
b. Raporti shkencor (studimi) paraqitet sipas strukturës së mëposhtme:
   i. Kopertina sipas modelit bashkëlidhur.
   ii. Përmbajtja e lëndës, ku jepet emërtimi i kapitujve e nënkapitujve dhe numri i faqeve përkatëse.
   iii. Lista e shkurtimeve të termave të përdorura (Faqe më vete).
   iv. Lista e ilustrimeve (figura, grafikë, harta, skica, etj.) (Faqe më vete).
   v. Hyrja.
   vi. Rezultatet shkencore të projektit.
   vii. Përfundime.
   viii. Rekomandime.
   ix. Literatura.
   x. Oponencat shkencore të projektit (dy).
c. Bashkë me raportin shkencor (studimin) duhet të dërgohen gjithashtu:
   i. Situacioni përfundimtar i shpenzimeve të kryera sipas pasqyrave bashkëlidhur duke plotësuar kolonën e shpjegimeve me komentet/përshkrimet e nevojshme.
   ii. Tabelë përmbledhëse me të dhëna për projektin e financuar
   iii. Kopje të faturave për shpenzimet e bëra gjatë periudhës të zbatimit të projektit.
   iv. Raportin e auditimit financiar të projektit nga strukturat përkatëse të institucionit përfitues.
   v. Skeda informative sipas modelit bashkëlidhur.

KREU 5.
MONITORIMI I PROJEKTEVE

5.1 Qëllimi i monitorimit

Procesi i monitorimit fokusohet në dy drejtime kryesore: a) në verifikimin e zbatimit të projektit sipas planifikimit të projektit të miratuar për financim, b) në shqyrtimin e raporteve të drejtuesve të projekteve mbi ecurinë e projekteve. AKKSHI nuk ka funksion të saj auditimin financiar të fondeve që ka përfituar institucioni i arsimit të lartë nga granti përkatës.

5.2 Fazat e monitorimit

a. Monitorimi i projekteve gjatë zbatimit të tyre realizohet nga AKKSHI mbi bazë kërkese dhe sipas nevojës.
b. Nëse e sheh të arsyeshme, AKKSHI kryen edhe monitorim fizik përmes vizitës në insitucionin përfitues.
c. Monitorimi përfundimtar realizohet nga AKKSHI pasi përfituesi ka dorëzuar raportin përfundimtar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë udhëzim.
d. Në rastin kur, pas shqyrtimit të raportit përfundimtar, rezultojnë pasaktësi apo mungesë dokumentacioni, AKKSHI njofton me shkresë zyrtare përfituesin me kërkesën për plotësim.
e. Përfituesi përcjell në AKKSHI raportin përfundimtar (së bashku me dokumentacioniin plotësues) të rishikuar jo më vonë se 10 ditë pune nga marrja e kërkesës.
f. Institucioni përfitues i grantit mban përgjegjësi të plotë lidhur me ndjekjen e procesit dhe të procedurave të realizimit të projektit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe për raportimin në kohë dhe sipas kërkesave të AKKSHI.

5.3 Detyrimet e aplikantit

Në procesin e monitorimit përfituesi ka detyrim :

a. të mundësojë aksesin në institucion për ekspertët e AKKSHI për monitorim fizik pas kërkesës dhe njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentacionin lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI-ja.
b. të japë informacion periodik mbi realizimin e projektit sa herë dhe në mënyrën që i kërkohet nga AKKSHI;
c. të hartojë raportin (periodik dhe përfundimtar) në afat dhe përputhje me modelin, kërkesat, dokumentacionin shoqërues të kërkuar nga AKKSHI.

5.4 Raportet e monitorimit

Pas përfundimit të monitorimeve AKKSHI harton raportin përkatës për çdo projekt të financuar nga AKKSHI.

KREU 6
ETIKA, PRONËSIA INTELEKTUALE, KONFLIKTI I INTERESTIT DHE KONFIDENCIALITETI

a. Aplikantët duhet të deklarojnë se do të respektojnë parimet kryesore etike dhe përcaktimet e kuadrit ligjor kombëtar dhe europian lidhur me etikën në kërkimin shkencor, si më poshte vijon:
   - Respektimi i dinjitetit dhe integritetit njerëzor
   - Sigurimi i ndershmërisë dhe transparencës ndaj subjektevekërkimore dhe veçanërisht marrja e pëlqimit dhe informimit
   - Sigurimi i privatësisë dhe konfidencialitetit
   - Promovimi i drejtësisë dhe i gjithëpërfshirjes
   - Minimizimi i dëmit dhe përfitimi maksimal
   - Respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe gjeneratave të ardhshme.

b. Përfituesit e grantit dhe partnerët e tyre në projekt duhet të tregojnë vëmendje të veçantë për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale dhe të respektojnë përcaktimet e kuadrit ligjo përkatës në fuqi.
c. Në çdo rast, aplikuesit, përfituesit, vlerësuesit dhe stafi teknik i AKKSHI zbaton parimet ruajtjes së konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

KREU 7
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

7.1. Kohëzgjatja e projektit

Kohëzgjatja e projekteve PKKZH dhe vlera e financimit përcaktohet në Vendimin e Bordit të Administrimit të AKKSHI për miratimin e Thirrjes për aplikime.